



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇE

VENDIM

Nr. 03, dt. 16.03.2018

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAMIN BUXHETOR
AFAT - MESHËM 2019-2021**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 11/2017 “Per Buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimit të Ministrise se Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, Udhëzimit të Ministrise se Financave nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të Udhëzimit të Ministrise se Financave nr.6/1 date 28/02/2018 “Per p[ërgatitjen e Buxhetit Vendor Afatmesem 2019-2021”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI:

1. Të miratojë tavanet përgatitore për përgatitjen e Programit Bbuxhetor Afatmesëm 2019-2021 sipas tabelës bashkangjitur:
 - Planin e transfertës së pakushtëzuar
 - Planin e transfertës së kushtëzuar
 - Planin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut
2. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria Ekonomike & Shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut



KESHILLI I QARKUT KORÇE

Tavanet Përgatitore të PBA 2019-2021

Transferta e pakushtëzuar Këshilli i Qarkut

2019	2020	2021
50,542,576	51,595,546	52,648,517

në lekë

Transferta e Kushtëzuar Funksion i deleguar - DAMT

2019	2020	2021
6,914,200	7,052,485	7,193,535

në lekë

Të ardhura të planifikuara Këshilli i Qarkut

2019	2020	2021
8,100,000	8,100,000	8,200,000

në lekë

TOTALI

2019	2020	2021
65,556,776	66,748,031	68,042,052

në lekë

Ana VERUSHI

Kryetar i Keshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇE

RAPORT

PËR HARTIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAM BUXHETIN AFATMESËM 2019-2021.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “ Për Veteqeverisjen vendore ”, në ligjin nr. 68/2017 “ Për Financat e vetëqeverisjes vendore ”, në udhëzimin nr 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”, Grupi i Menaxhimit Strategjik, kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut ju paraqet raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2019-2021 sipas strukturës së mëposhtme:

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-së 2019-2021

1. Ngritja e grupit të punës

Nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe përgatitjen e projekt buxhetit afatmesëm me ndarjen sipas programeve të Këshillit të Qarkut. Grupi i Menaxhimit Strategjik do të mbështetet në kalendarin e programit buxhetor afatmesëm miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 17 datë 18.12.2017, për të vepruar sipas strukturave përkatëse me qëllim realizimin e çdo detyre sipas afateve të përcaktuara në vendim.

2. Ndarja e kuotave sipas programeve

Nën drejtimin e Kryetarit të GMS, grupi i punës ka punuar për planifikimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 mbështetur:

- Mundësitë reale të realizimit të burimeve të të ardhurave, si kusht për financimin e shpenzimeve.
- Analizën e realizimit të buxhetit në dy vitet paraardhëse si dhe në zbatimin e tij për vitin 2018.
- Ritjen e lejuar të transfetes së pakushtezuarve parashikuar me Udhezimin e Ministrisë së Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”

- Ritjen e lejuar te transfetes se pakushtezuar te parashikuar me Udhëzimin e Ministrise se Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”
- Programi i aktiviteteve per vitin 2018 per institucionin e Keshillit te Qarkut te lidhura me objektivat e zhvillimit te qeverisjes qendrore.
- Parashikimi I pritshem I kontratave per implementimin e projekteve te frituara me fonde te Bashkimit Europian ne kuader te Programeve te Bashkepunimit nderkufitar IPA CBC Greqi – Shqiperi 2014-2020.
- Normativat e lejuara te shpenzimeve te miratuara me akte ligjore dhe nenligjore.

Programi	Emertimi i të Ardhurave	Fakti 2016	Fakti 2017	Plani për vitin 2018
01110	Të ardhurat e veta	9137439	1730991	7800000
01110	Transferta e pakushtëzuar	46495324	47421446	49489605
01110	Transf. të kushtëz. F. Zhvillim I Rajoneve	900010	0	0
01110	Të ardhurave te trashëguara	19530000	34343000	57527469
01160	Transferta të kushtëzuara DAMT	5967000	6920000	6770000
	Të ardhurat gjithsej	82029773	90415437	121587074

Sipas udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021” dhe VKQ nr 13 datë 18.12.2017 “Mbi miratimin e Buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2018” u bënë llogaritjet për transfertat e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara. Ky udhëzim përcaktonte rritjen e transfertës së pakushtëzuar në vlerë, jo në përqindje si ishte llogaritur vitet e kaluara. Duke u mbështetur në këtë udhëzim u bënë llogaritjet për tre vitet në vazhdim për vitin 2019 transferta e pakushtëzuar është 50,542,576 lekë, për vitin 2020 transferta e pakushtëzuar është 51,595,546 lekë dhe për vitin 2021 transferta e pakushtëzuar është 52,648,517 lekë. Po ti konvertosh në përqindje këto vlera, rritja nga viti në vit është mesatarisht 2%.

Grupi diskutoi rreth buxhetit, burimeve financiare për tre vitet e ardhshme, të përbërë nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e vet institucionit nga shërbimet që ofron dhe të ardhurat nga kontributi financiar i Bashkive. Pjesë e diskutimit ishin dhe projekt idetë për aktivitete që do të planifikohen në vitet në vazhdim me synim arritjen e objektivave të Keshillit të Qarkut. Në lidhje me të ardhurat e veta GMS u mbështet në realizimin e të ardhurave të vitit 2017, si shërbimet që ofron K. Qarkut dhe realizimi i kontributit financiar të Bashkive sipas realizimit të të ardhurave të tyre.

Programi	Emërtimi i të Ardhurave	Parashikimi për vitin 2019	Parashikimi për vitin 2020	Parashikimi për vitin 2021
01110	Të ardhurat e veta	8100000	8100000	8200000
01110	Transferta e pakushtëzuar	50542576	51595546	52648517
01160	Transferta të kushtëzuara DAMT	6914200	7052485	7193535
	Të ardhurat gjithsej	65556776	66748031	68042052

Për Këshillin e Qarkut mbetet prioritet “Zhvillimi dhe zbatimi i politikave rajonale në Qarkun Korce, në fushat ekonomike, turizmit, kulturës, shërbimit social, trashëgimisë kulturore, mjedisit etj, harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes vendore në bashkëpunim me Bashkitë e Qarkut dhe ushtrimi i funksioneve të deleguara“

Këshilli i Qarkut është në pritje të nënshkrimit të marrëveshjeve për zbatimin e projekteve të fituara me fondet e Bashkimit Europian të cilat do jenë burime shtesë për realizimin e objektivave të institucionit.

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Kryetari Keshillit Qarkut	Ana Verushi
Drejtore Finances	Liljana Pleqi
Shefi i Kabinetit, keshilltar juridik	Gjergji Eski
Keshilltare per Projektet Komunitare	Mariela Alickolli
Specialist per Urbanistiken dhe Mbrojtjen e Teritorit	Anesti Teneqexhi
Specialist per Sherbimet dhe Burimet Njerezore	Edi Qirinxhi